



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 21

Datë: 26. 08. 2022. Ora: 11: 00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.19 dhe 20**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së:**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Rekomandim për pezullimin e partisë politike Partia e Ashkalinjëve të Kosovës-PAI;
 - Rekomandim për çregjistrim të partisë politike Pokret za Župu i Diasporu ;
 - Shqyrtim i kërkesës për shtyrje të afatit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor të partisë politike Ujedinjena Stranka Bošnjaka-USB.
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Hani i Elezit.

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Raporti gjashtëmuor financiar për periudhën 1 Janar - 30 Qershor 2022;
- Raporti i shpenzimeve të Derivateve Janar - Qershor 2022;
- Shqyrtimi i kërkesës për transferim te buxhetit brenda programit te organizatës.

Të ndryshme.HULUMTIMI DHE ANALIZIMI I FLETËVOTIMEHULUMTIMI DHE ANALIZIMI ZGJEDHJET

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Kemi mbledhjen 21 dhe, rendin e ditës !

Pas paraqitjes së rendit të ditës, kryetari Radoniqi pyeti anëtarët e KQZ-së dhe të pranishmit nëse, dikush ka dicka lidhur me rendin e ditës ?

Burim Ahmetaj, tha se janë dy propozime: shkresat që kanë ardhur nga Agjencioni Antikorrupsion dhe këshilli i ka shqyrtuar ato, dhe një njoftim nga komisioni për ligjin për paga. Pra, këto janë të diskutohen nga KQZ.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin nr 20/2022 nga mbledhja e KQZ-së, kurse procesverbali nr. 19 u kalua pa u votuar pasi që, për arsye teknike nuk është regjistruar mbledhja. Pra, nuk kishte se si të votohej...

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Ahmetaj tha fillimisht se në planin e punës 2022, për aktivitetin nr. 35 “Tjetërsimi i pasurive jo financiare të KQZ-së nëpërmjet shitjes dhe donimit” janë

ndërmarr veprime për ti përgatitur materialet për donacion (falje) dhe për tjetërsimin përmes ankandit publik. Mirëpo, për t'i zhvilluar të gjitha këto procedura nevojitet hartimi dhe miratimi i rregullativës dhe i procedurave për tjetërsim të pasurisë jo financiare. Lidhur me këtë, është formuar komision për hartimin e rregullativës dhe procedurave për tjetërsim të pasurisë financiare, ku drafti final pritet të përgatitet më së largu deri me 31 gusht. Sekretariati është duke u përgatitur edhe për dy aktivitetet të cilat pritet të zhvillohen gjatë muajit shtator siç, janë aktiviteti nr. 54: “Organizimi i takimeve KQZ me Kryetar të Komunave dhe Kryesuesit e Kuvendeve Komunale” si dhe aktiviteti nr. 6: “Forcimi i komunikimit ndërmjet Zyrtarëve Komunal të Zgjedhjeve dhe Sekretariatit të KQZ-së”, aktiviteti i cili përkrahet nga OSBE.

Gjatë muajit shtator, parashihet të organizohet takimi i tretë nga katër takimet sa janë paraparë me planin e punës. Aktivitetet e tjera nga plani i punës siç, janë Hartimi i Strategjisë për trajnimin e Trupave Menaxhuese Zgjedhore si dhe analizimet e vendvotimet e rinumëruar, trendët zgjedhore, janë në proces e sipër.

Në vazhdim, Ahmetaj tha se aktiviteti i planit të punës nr. 11: “Shkatërrimi i materialeve të ndjeshme zgjedhore nga Zgjedhjet Lokale të mbajtura në vitin 2021”, ka qenë paraparë të zhvillohet gjatë muajve mars-maj 2022. Sekretariati ka raportuar në KQZ për vështirësitë për implementimin e këtij aktiviteti për shkak të specifikimit të paqartë në kontratë në lidhje me materialin i cili, pas grirjes obligon operatorin ekonomik të tërheqë pa e specifikuar vendin se ku do ta sistemojë, me ç'rast aktiviteti i prokurimit është anuluar dhe më pastaj është rishpallur sërish tenderi.

Sekretariati ka shqyrtuar opsionet për implementimin e këtij aktiviteti për të cilin para se të zhvilloheshin procedurat e prokurimit kanë qenë dy opsione: Opsioni i parë që të jetë përmes ankandit publik (grirja dhe shitja e mbetjeve të letrës pas grirjes) dhe opsioni i dytë që operatori ekonomik që shkatërron materialin zgjedhor, të njëjtin të shkatërruar do ta largojë nga depoja e KQZ-së dhe atë e merr operatori.

Ai tha se, përkundër përpjekjeve Sekretariati konsideron se procedura më e shpejtë për shkatërrimin e materialeve zgjedhore dhe pastrimin nga mbetjet e letrës pas grirjes, është opsioni i dytë ku për grirjen e letrës respektivisht materialit zgjedhor, shërbimin e grirjes e bën operatori ekonomik i cili më pastaj mbetjet e letrës pas grirjes i largon nga depoja e KQZ-së dhe, e merr operatori ekonomik. Pas këtij vlerësimi, Sekretariati ka zhvilluar procedurën e prokurimit për këtë aktivitet sipas opsionit të dytë dhe pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, është përzgjedhur OE, është caktuar Menaxheri i Kontratës dhe formimi i komisionit për mbikëqyrjen e procesit të shkatërrimit të materialit zgjedhor. Ky proces pritet të fillojë gjatë javës së ardhshme.

Po ashtu, aktivimet tjetër apo sfidë e Sekretariatit janë materialet zgjedhore. Në vitin 2012, janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj dhe në Kaçanik. Për këto procese, Prokuroria e Shtetit dhe PZAP kanë kërkuar të ruhen materialet zgjedhore të disa vendvotimeve, por të cilat tashmë e kanë arritur parashkrimin absolut. Sekretariati konsideron se ato duhet të asgjësohen njëjtë sikur materialet zgjedhore të ruajtura nga viti 2007, 2009, 2010 dhe 2011. Sekretariati ka dërguar shkresë Prokurorisë së Shtetit në lidhje me këto materiale zgjedhore nga viti 2012, mirëpo ende nuk ka ndonjë përgjigje.

Aktivitet tjetër është strategjia e KQZ-së (2023-2026). Grupi Punues për hartimin e strategjisë, ka mbajtur takim e radhës më 17 gusht 2012, dhe është dakorduar për hapat e radhës brenda këtij aktiviteti.

Gjithashtu, po përgatitemi për pjesëmarrje në Konferencën e pestë të Asamblesë së Përgjithshme të A-ËEB që mbahet në Afrikën e Jugut. Siç e dimë, KQZ ka marrë vendim që të aplikojë për postin e Zëvendës Kryesuesit të AËEB-it, si dhe pjesëmarrjen në Konferencën e Pestë të Asamblesë së Përgjithshme, e planifikuar të mbahet në Cape Toën, nga data 17-22 tetor 2022. Sekretariati i A-ËEB, ka thënë Ahmetaj, i mbulon shpenzimet e akomodimit për dy anëtar të delegacioneve të të gjitha shteteve anëtare të A-ËEB.

Sekretariati, raportoi në fund Ahmetaj para anëtarëve të KQZ-së, është duke u përgatitur edhe për vëzhgimin e zgjedhjeve në Letoni (1 tetor 2022) dhe pjesëmarrjen në Konferencën e 19-të të Trupave Menaxhuese Zgjedhore të organizuar nga Komisioni i Venecias, që do të mbahet në Strasburg me 14 dhe 15 nëntor 2022.

Alim Rama: Nuk kam pyetje por kam një shqetësim sepse, ne jemi duke shkatërruar për një kohë të gjatë materialet, mbas një viti – dy në tjetërsimin e pasurive jo financiare, po e shohim që nuk kemi procedura dhe rregullore! Ky është një lëshim i Sekretariatit dhe besoj që kjo nuk duhet të përsëritet ma sepse, po ky është lëshim...

Arianit Elshani: Lidhur me takimet me kryetarët e komunave me anëtarët e KQZ, kjo mendoj të trajtohet si plan sepse e kemi pasur edhe në KOZ, dhe kjo të shtyhet për muajin e shtatorit. E kemi miratuar strategjinë e Listës Votuese, dhe ndarjen e QV – analizën për ndarjen e QV-ve, mendoj që këto duhet ti trajtojmë bashkërisht në KOZ dhe të bëjmë një plan të takimeve...

Kreshni Radoniqi: Kam diçka që s’ka të bëj me raportimin por, me sekretariatit! Dje, e kam marr një informacion nga Gjykata e Pejës. Kjo gjykatë ka lëshuar urdhrin për numërimin e disa kutive, po ashtu edhe prokuroria në bazë të hetimeve që ata janë duke u zhvilluar. Nuk është ky problemi i vetëm, sepse shqetësohem se mund te kemi edhe raste tjera...

Gjykata e ka në procedurë e sipër rastin për gjykim rastin, dhe prej KQZ shkon raportimi se nuk janë gjetur kutitë e votimit, dhe i thotë gjykatës se në momentin që i gjejmë i sjellim...Gjykata duhet ti ketë provat për me marrë vendim...Shqetësimi im është se, pse nuk janë gjetur kutitë! A keni ndonjë përgjigje ?

Burim Ahmetaj: Fjala është për materialet vitit 2019. Kemi pasur shumë rinumërimë me kërkesë dhe urdhëresë të gjykatave në regjionin e Pejës. Kutitë janë, dhe duhet me i gjet. Është marrë vendim, ato janë por, mbase numri i madh i rinumërimeve dhe nuk janë gjet, por ne do ta kemi prioritet gjetjen e tyre...

Kreshnik Radoniqi: Gjatë javës së ardhshme, shikoni se ku janë, dhe shikoni mos edhe ndonjë gjykatë e ka problemin e njëjtë...

6. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Rekomandim për pezullimin e partisë politike Partia e Ashkalinjëve të Kosovës-PAI:

Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP-se tha se, sot kemi dy rekomandime dhe një kërkesë. Rekomandim i parë ka të bëjë me pezullimin e partisë politike “Partia e Ashkalinjëve të Kosovës-PAI.” Kjo parti, ka bërë njëherë kërkesë për shtyrjen e afatit të mbajtjes së kuvendit sepse nuk e ka mbajtur me kohë, mirëpo ky subjekt as deri më 31 korrik që ishte afati shtesë i dhënë nga KQZ nuk e ka mbajtur kuvendin. Zyra, rekomandon pezullimin e këtij subjekti dhe sipas ligjit, subjektit i jepet edhe një afat shtesë prej 54 ditëve për ta mbajtur kuvendin...

Sami Kurteshi, tha se a mos ky subjekt ka vetëm probleme financiare, apo kanë edhe marrëveshje të brendshme...?

Fazli Stollaj, kjo parti i përfaqëson Ashkalinjë dhe kanë pasur probleme, po vetë kryetari i këtij subjekte ka pasur probleme! Sigurisht, kanë probleme edhe në organet udhëheqëse të partisë, kështu që unë kisha kërkuar që ky vendim të shtyhet për dy muaj... Dhe, tu jepet përsëri mundësia meqë, është parti përfaqësuese e një komuniteti..

Në këtë pikë shtruan pyetje dhe diskutuan edhe: Arianit Elshani, Čemailj Kurtiši, Ilir Gashi, Alim Rama, Nexhmedin Hyseni, drejtor i zyrës, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi dhe Sami Kurteshi.

Pas diskutimeve shpjeguese dhe analizuese nga anëtarët e KQZ-së, në fund u votua: me 5 vota për, 1 kundër dhe 3 vota abstenim rekomandimi i zyrës nuk mori votat e mjaftueshme – nuk kaloi.

Rekomandim për çregjistrim të partisë politike “Pokret za Župu i Dijasporu”:

Neshmedin Hyseni: Edhe këtë kërkesë, zyra e ka proceduar dhe i ka rekomanduar KQZ-së për çregjistrim, sepse përkundër shtyrjeve 2 herë, ky subjekt nuk e ka respektuar as afatin shtesë prej 45 ditëve. Të gjitha afatet e dhëna, janë me vendim të KQZ-së mirëpo, subjekti në fjalë nuk i ka respektuar afatet dhe ne, e rekomandojmë për çregjistrim nga regjistri i partive politike.

Sami Kurteshi: Pyes se, çka është në pyetje. Sidomos e pyes Cemalin, meqë bëhet fjalë për një subjekt boshnjak!

Čemailj Kurtiši: Ndoshta, nuk është korrekte që unë të përgjigjem në këtë pyetje, por ne duhet ti referohemi ligjit: nuk janë në gjendje të organizohen, strukturat nuk arrijnë ta mbajnë kuvendin dhe mendoj që, ne duhet të jemi madje rigoroz. Kovidit ishte pengesë, por tash nuk e kemi kovidin problem, dhe s’kemi çka...! Kjo vlen edhe për subjektet tjera qoftë, edhe nëse është parti parlamentare! Madje, pikërisht partita parlamentare duhet ta respektojë ligjin...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, e hedh në votim: Kush është për rekomandimin e zyrës për çregjistrim të partisë politike “Pokret za Župu i Dijasporu” ?

Me 10 vota për miratohet rekomandimi për çregjistrim të këtij subjekti.

Shqyrtim i kërkesës për shtyrje të afatit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor të partisë politike “Ujedinjena Stranka Bošnjaka-USB.”

Nexhmedin Hyseni: Kemi një kërkesë tjetër për shtyrje të afatit për mbajtjen e kuvendit! Bëhet fjalë për partinë politike: “Ujedinjena Stranka Bošnjaka-USB.” Mbi bazë të ligjit, sipas procedurave këtë vit janë në rend të mbahen 70 kuvende, mirëpo për arsye të ndryshme, sidomos për arsye të kovidit kërkesa kemi pasur, dhe është edhe kjo kërkesë për shtyrje të afatit për mbajtje të kuvendit zgjedhor... Ky subjekt, e kishte afatin e rregullt të mbajtjes së kuvendit deri më 17 korrik 2022, ndërsa tani ata kanë kërkuar shtyrje të afatit deri më 8 tetor...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, e hedh në votim: Kush është për rekomandimin e zyrës për shtyrje të afatit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor të partisë politike: “Ujedinjena Stranka Bošnjaka-USB.”

Anëtarët e KQZ-së miratuan kërkesën e kësaj partie për shtyrje të afatit deri më datën 8 tetor, 2022.

P. s. Sërish u diskutua çështja e pezullimit të partisë politike “Partia e Ashkalinjëve të Kosovës-PAI”. Në këtë pikë, diskutuan Sami Kurteshi, Sami Hamiti dhe Ilir Gashi,

Kreshnik Radoniqi, i cili propozoi një afat prej “45” ditë për mbajtjen e kuvendit, dhe nëse ata se mbajnë atëherë, presim një rekomandim nga zyra...

Deri më 10 tetor, PAI e ka afatin për mbajtjen e kuvendit...

Anëtarët e KQZ-së, e mriatuan këtë propozim të kryetarit Radoniqi.

7. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Hani i Elezit.

Sami Hamiti: Në mbledhjen e fundit të këshillit për çështje ligjore, e kemi trajtuar kërkesën e kryesuesit të kuvendit komunal në Han të Elezit për zëvendësimin e një anëtari të kuvendit. Kështu që, propozojmë që Erblin Malitiqi të emërohet anëtar i ri i kuvendit nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Veton Ballazhi.

Miratohet...

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

1. Raporti gjashtëmuor financiar për periudhën 1 Janar - 30 Qershor 2022;

Ilir Gashi: Këshilli, pardje ka mbajtur takimin. Kryesuesja e këtij këshilli për arsye shëndetësore nuk ka marrë pjesë. Unë e kam kryesuar takimin. Pikat që i kemi shqyrtuar, i keni pasur, pra e keni edhe raportin gjashtëmuor financiar për periudhën: 1 Janar - 30 Qershor 2022. Pastaj, e kemi shqyrtuar edhe “Raporti i shpenzimeve të Derivateve Janar - Qershor 2022”, si dhe kemi bërë një shqyrtim të kërkesës për transferim te buxhetit brenda programit të organizatës.

Sa i përket pikës së parë, tha z. Gashi, raporti është tek ju. Ne, në bazë të ligjit, fondi i cili është prej 5 milion e 913 mijë e 951 euro (5, 913, 951 euro) është fond i institucionit për përmbushjen e nevojave dhe

detyrave që kemi si institucion ligjorë. Shumat janë, dhe deri më tani është shpenzuar 46.05% e buxhetit në këtë periudhë...

Si këshill, ne e kemi miratuar me disa vërejtje të vogla të cilat, besoj janë i inkorporuar. Ne, e rekomandojmë për miratim...

Në këtë pikë, diskutoi **Alim Rama**, tha se veç vërejtjeve që kemi dhënë që shpenzimet të bëhen sipas planit, kemi pas vërejtje teknike që sa po e shoh, nuk janë përfshirë në raport. Mendoj që, duhet të jemi transparent, sidomos te shpenzimet "Mallrat dhe Shërbimet" që është vështirë të nxirren ato që janë shpenzuar "22%" por, dihet që performanca jonë varet prej projekteve që ne i realizojmë nga plani i punës...

Sami Hamiti, tha se ky është një raport financiar, dhe jo raport i punës ? Niveli i shpenzimeve është i ulët, sepse nivelin e shpenzimeve për projektet kapitale për shembull, e kemi 0%...! Është nivel i ulët i shpenzimeve të buxhetit, Raporti si raport i përmban kriteret, ashtu si e përcakton ligji i Financave Publike, ashtu edhe kemi rekomanduar për aprovim...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për miratimin e këtij raporti ? Me 10 vota për, miratohet raporti gjashtëmuor financiar për periudhën 1 janar - 30 qershor 2022.

3. Raporti i shpenzimeve të Derivateve Janar - Qershor 2022:

Ilir Gashi, tha se në takimin e këshillit, është shqyrtuar edhe raporti gjashtëmuorë i shpenzimeve për derivate, dhe kemi konstatuar se janë shpenzime konform përdorimit të automjeteve... edhe pse, në ndërkohë, gjatë udhëtimeve kemi shkuar me vetura që, janë në emrin e tjetrit por, ato janë shpenzim

Arianit Elshani, në disa tabela teknikisht është i shkruar gabimisht emri im, kërkoj përmirësim përpara se të nënshkruhet...

Sami Hamiti: Ilir Gashi, për shembull e ka përdorë veturën që nominalisht, është në emrin tim, por shpenzimet kanë ndodh sepse është shkuar për udhëtim zyrtar...Niveli i shpenzimeve për kilometra në derivate është atillë, që s'ka vend për ndonjë manipulim...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e këtij raporti ? Me 10 vota për, miratohet raporti gjashtëmuor financiar për derivate periudhën 1 janar - 30 qershor 2022.

3. Shqyrtimi i kërkesës për transferim te buxhetit brenda programit te organizatës:

Ilir Gashi: Në takim të këshillit, ishte edhe shqyrtimi i raportit për transferim te buxhetit brenda programit te organizatës, ne jemi informuar për një aktivitete të prokurimit. Ne, kemi kërkuar informata shitesë, dhe se ne nuk e kemi hedhur por as miratuar...

Burim Ahmetaj, tha se nga IT është dërguar imelli me arsyeshmëri sepse, nevojitet licenca për programi, nevojitet dizajni i formularëve dhe dokumenteve të ndryshme, fletëvotimet, broshurat, certifikatat për regjistrim të partive politike, dhe dokumente të tjera. Kjo, për programet e punës së përditshme, e ku hyjnë edhe ueb faqja e KQZ-së...Pa licenca, nuk e di se si kryhet kjo punë dhe prandaj, licencat janë të nevojshme...

Kreshnik Radoniqi: Kërkesa, është me i shtua 1580 euro, a po...?

Alim Rama, tha se ne se kemi kontestua nevojën e softverit, por tabelat janë jo në koherencë me çmimet, dhe në këshill, çmimet nuk korrespondojnë, dhe ne kemi lypë shpjegime...

Burim Ahmetaj, shpjegoi se kjo çështje, ka ndryshuar për shkak të tenderimeve, çmimeve të operatorëve dhe dy tenderë veç janë anuluar..

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Kreshnik Radoniqi, Burim Ahmetaj, Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Ilir Gashi kryesisht rreth faktit se pse ka ndodh ky ndryshim në çmimi, ose pse kërkohet një çmim tjetër dhe, gjetjen e një modusi për tenderimin dhe realizimin e këtij projekti...

Në fund, anëtarët e komisionit vendosën që të anulohet tenderi, të rritet shuma dhe, të rishpallet pastaj tender i ri...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, me 9 vota për dhe një abstenim (Sami Kurteshi), të zhvillohet procedurë e re prokurimit për “Furnizim me Licenca Adok dhe Korell dra” për të cilin, alokohet shuma edhe për 1700 euro.”

Kreshnik Radoniqi: Përpara se të hyjmë në pikën “Të ndryshme!”, i kemi kërkesat e Agjencisë Antikorrupsion, dhe duhet t’i trajtojmë pak...

I kemi 3 kërkesa: Një, kërkesë ishte e datës 14.06.2022 në kohën kur ishte Ligji 03/159 ishte në fuqi, deri më 5 gusht! Nga kjo ditë, ka hy në fuqi ligji i ri dhe, kur ka ardhur kërkesa e parë me 14 qershor, ju kemi përgjigjur...Jemi përgjigjur sepse, ligji i mëhershëm i agjencionit sipas nenit 5 i ka pas kompetencat më të zgjeruara – nuk ka pas kufizim. Ligji i ri që ka hy në fuqi me 1 korrik 2022, e që është në fuqi nga 5 gushti,

i ka përkufizuar disa kompetenca të AAK-së. (Kryetari e citoi nenin 5, i cili e përkufizon kompetencën – përgjegjësinë e re të agjencionit).

Jemi përgjigjur sepse, ka qenë obligim. Por tash, ligji i ri ja kufizon kompetencat. Kanë të drejtë me kërkue nga ne për disa çështje, si për shembull për dhuratat, por jo për çështje të rekrutimit, ato financiare...Tash, është ligji i ri...!

Sa i përket zbatimit të ligjit, tani AAK nuk ka drejtë me kërkua sepse, neni 31 i ligjit të ri, e shfuqizon ligjin e vjetër. I shfuqizon disa kompetenca...

Alim Rama: Kjo ka fillua me ligjin e vjetër, veprimtaria ka fillue kur ka qenë ligji i vjetër ! Këto kërkesa janë administrative, dhe pse duhet me pas debat. Ne jemi institucion për zgjedhje, i pavarur por, ne i respektojmë edhe institucionet e tjera... por, disa vendime pse duhet ne ti diskutojmë...? Auditimet, emërimet ose mos emërimi, as nuk i di, por ne jemi institucion publik dhe s’kemi pse me ju përzie institucionet tjetër se a të heton a s’heton... Ne jemi institucion i pavarur, por çka do që ka të bëj me zgjedhjet është përgjegjësia jonë...Sa i përket administrimit, përgjegjësisë financiare - të gjitha këto vendime kan pasur pasoja financiare...

Ilir Gashi: E para, unë e mbështes konstatimin e kryetarit. E dyta, kuvendi ka miratue edhe një ligj tani që për mue është skandaloz dhe antikushtetues. Por nëse ka hy në fuqi, “në bazë të kësaj logjike nuk ban me zbatue se e kemi krye punën me ligjin e vjetër”, por meqë ka ndodhë me ligjin e vjetër ne “nuk ban me marrë asnjë veprim pavarësisht se ligji i ri ka hy në fuqi”...Tjetra, unë mendoj se ka pretendime, çka – pse, por për “çështjen Xharra” është qasje në dokumente dhe veprim i Sekretariatit ose i Kryeshfit, por vendimet e KQZ-së sa i përket kryeshfit, zëvendëskryeshfit dhe drejtorit janë vendime tona, vendime të KQZ-së... Ligji i ri që ka hy në fuqi dhe i cili e ka shfuqizue ligjin e vjetër, nuk ja lejon ma këto të drejta...

Ne, i zbatojmë ligjet e tjera, por pavarësia e institucionit nuk duhet me u lejua me u cenua.. vendimet tona janë kolegjiale, prandaj përgjigjet tona duhet të jenë të arsyeshme...

Kreshnik Radoniqi: Të dy shkesat kanë ardhur gati përnjëherë, njëra me 5 gusht, tjetra me 15... Këto, kanë të bëjnë me ligjin e ri, dhe kjo e shfuqizon ligjin e vjetër...

Sami Hamiti: Kërkesat që janë, e që janë kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrëse e nuk janë fare të AAK-së, po edhe sikur të ishte, të gjitha shkresat janë të adresuara masi ka hy në fuqi ligji i ri...

Nëse, shkresat janë nisë me 16, kur ka hy në fuqi ligji i ri e, ato janë ba në bazë të ligjit të vjetër, kjo është huqje totale...

Shkresat, po duket janë ba ma herët, po i ka zanë ligji i ri ! Shkresat, duhet me u trajtue me ligj të ri ! Ka hi ligji i ri në fuqi, ne tan jetën s' mujna mu marrë me ligjin e vjetër...

Čemailj Kurtiši: Mendoj që zyra ligjore duhet të merret me këto kërkesa, dhe bashkë me ju kjo të shikohet...

Të përkufizohet: çka po kërkohet, dhe zyra ligjore të merret me këtë, të mos humbim kohë, të shohim çka e qysh...!

Sami Kurteshi: Çfarëdo që të jetë, unë mendoj se ne duhet ta kthejmë një përgjigje...! Ata na kanë dërgua shkresë, dhe ne ua kthejmë shkresën me përgjigjet...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Alim Rama, Kreshnik Radoniqi i cili kundërshtoi kërkesat e AAK-së për rekrutime sepse nuk është në kompetencë, as çështjet e auditimit...Ata, munden me hapë konflikt administrativ në gjykatë, por ne jemi kategori kushtetuese...

Nuk kemi çka me fshehë, por as nuk kemi pse të përgjigjemi...! Por, jemi duke e diskutuar sepse, unë nuk kam mundur me marrë vendim krye më vete...

Ilir Gashi, propozoi që të votohet dhe kryetari, në emër të KQZ - së ta kthej përgjigjen...

Kreshnik Radoniqi: Propozimi im është që t'i refuzojmë kërkesat... Prandaj, e hedh në propozim...!

Me 9 vota për, dhe me një abstenim (Alim Rama), miratohet propozimi për refuzimin e këtyre kërkesave të Agjencionit Antikorrupsion.

Kreshnik Radoniqi: Kam edhe disa çështje: Së pari rregullat zgjedhore kanë mbetur në gjysmë, por duhet të mblidhemi sa më parë dhe t'i trajtojmë, sepse duhet ta përmbyllim...

Arianit Elshani: Të gjitha janë trajtuar në këshill, veç njëres që ka mbete...Të gjitha të tjerat, kurdo janë gati...

Sami Kurteshi: Na i përcillni rregullat...se, unë si kam pa...

Kreshnik Radoniqi: A jemi për të mërkurën, me fillua, me 31 gusht nga ora 10:30 minuta...Pra në këtë kohë...

I kemi edhe rregullat e brendshme, edhe këto janë shumë me rëndësi me u trajtua...Ne duhet me i pas, dhe me fillua me i trajtua bashkë me grupin që ka punua...

I kemi edhe dy vizita: Në Tiranë...ODIRI na ka dërgue imellat në bazë të funksioneve, por unë nuk mundem me marrë pjesë....Janë kërkuar katër persona, por unë dhe Besnik Buzhala nuk mundemi me shkue, por propozoj që Alimi dhe Ariainiti të shkojnë prej KOZ, meqë është çështja për “identifikimin elektronik”.... Kjo, me 20 - 21 shtator...

Anëtarët e KQZ-së, e miratuan këtë propozim...

Po ashtu, sot në mëngjes e kam pasur një takim dhe, fjala është për një organizim në Zvicër. Ene sa vendos për agjendën, nuk e di ende ku mbahet. Prej Kosove, janë kryesuesi i KQZ-së, dhe kryeshefi i Sekretariatit...Ky është plani, por ende nuk është përpilua... Ende nuk kam asgjë zyrtare, por si propozim...

(P.s. Më tej, është diskutuar edhe për disa vizita të tjera, mirëpo incizimi është i papërdorshëm sepse, është i shkëputur dhe, nuk mund të zbardhet saktë, madje as përafërsisht...)

